REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 15 Prot. Gjirokastër, më 05/01/2024

# VENDIM

**Nr. 01, datë 05.01.2024**

**PËR**

**DETAJIMIN E BUXHETIT TË AKORDUAR NGA SHTETI PËR VITIN 2024**

Në zbatim të nenit 38 pika 3 të Ligjit 80/ 2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë "*; Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 " *Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"; Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për menaxhimin e buxhetit shtetëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "*Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " *Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor*"; të nenit 19 pika 2 të *Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër;* propozimit të Administratorit nr. 09, datë 04.01.2024, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 05.01.2024, mori në analizë draftin e paraqituur nga institucioni i administratorit për detajimin e buxhetit të akorduar nga shteti për vitin 2024 dhe

**VENDOSI**

1. Të miratojë fondin e pagave për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ në shumën 220.152.962 (dyqind e njëzetë milion, njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë;
2. Të miratoj fondin e sigurimeve shoqërore në shumën 37.000.000 (tridhjetë e shtatë milion) lekë;

3. Të miratoj fondin për bursat e studentëve në shumën 12 220 000 (dymbëdhjetë milion, njëqind e njëzetë mijë) lekë;
4. Të miratoj fondin për shpenzime operative në shumën 23.000.000 (njëzetë e tre milion) lekë.
5. Vendimit i bashkelidhet propozimi i administratorit per detajimin e buxhetit.
6. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

***Ky vendim hyn në fuqi menjehërë!***

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**
**Prof. dr. Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 16 Prot. Gjirokastër, më 05.01./2024

# VENDIM

## Nr. 02, datë 05.01.2024

## PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE PËR ÇDO PROGRAM STUDIMI PRIORITAR

Në mbështetje të pikës 6, të VKM-së nr. 386, datë 01.06.2022 "*Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë*", të ndryshuar; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 230/9; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 233/9, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës 05.01.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shpërndarjen e kuotave për çdo program studimi prioritar si vijon:
    a. 1 (një) kuotë për programin e studimit "Turizëm";
    b. 1 (një) kuotë për programin e studimit "Mësues për Arsimin Parashkollor";
    c. 1 (një) kuotë për programin e studimit "Biologji-Kimi";
    d. 1 (një) kuotë për programin e studimit "Histori-Gjeografi";
    e. 1 (një) kuotë për programin e studimit "Gjuhë dhe Letërsi Shqipe"
2. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim, si dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në formë shkresore dhe në rrugë elektronike.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## SENATI AKADEMIK

Nr 17 Prot. Gjirokastër, më 05/01/2024

# VENDIM
**Nr. 03 , datë 05.01. 2024**

## PËR STUDENTËT E PËRZGJEDHUR SI PËRFITUES, NGA LISTA E APLIKIMEVE QË I PLOTËSOJNË KUSHTET, NË PROGRAMET E STUDIMIT QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Në mbështetje të pikës 6, të VKM-së nr. 386, datë 01.06.2022 "*Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë*", të ndryshuar; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 230/9; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 233/9, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës 05.01.2024,

## VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve të përzgjedhur si përfitues, nga listat e aplikimeve që i plotësojnë kushtet, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2023-2024, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim, si dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në formë shkresore dhe në rrugë elektronike.

***Ky vendim hyn në fuqi menjëherë***

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

*Shtojcë*

**UNIVERSITET "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**
**LISTA E STUDENTËVE PËRFITUES TË MBËSHTETJES FINANCIARE, PËRZGJEDHUR NGA LISTA E APLIKIMEVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET, SIPAS NOTËS MESATARE NË PRANIM, BAZUAR NË KËRKESAT E VKM NR. 386/2022, TË NDRYSHUAR**
**VITI AKADEMIK 2023-2024**

| Nr. | Emër, Atësi, Mbiemër | Nr. Indetifikimit të studentit | Fakulteti ku është regjistruër studenti | Programi i studimit prioritar ku është regjistruar studenti | Nota mesatare në pranim e studentit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Majlinda Metlli Memushi | K55502026U | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore | Gjuhë-Letërsi Shqipe | 8.81 |
| 2 | Dalbero Robert Çelo | K50523069G | Fakulteti Ekonomik | Turizëm | 8.46 |
| 3 | Fjodora Kujtim Çela | K55412011U | Fakulteti Shkencave të Natyrës | Biologji-Kimi | 8.43 |
| 4 | Greta Taulant Hamata | J65726097T | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore | Histori-Gjegrafi | 7.95 |
| 5 | Samanta Arben Dajlani | K55820023D | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore | Mësues për Arsimin Parashkollor | 7.5 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 18 Prot. Gjirokastër, më 05/01/2024

# VENDIM

**Nr. 04, datë 05.01.2024**

## PËR
## MIRATIMIN E STRUKTURËS AKADEMIKE, ADMINISTRATIVE DHE NUMRIN E PERSONELIT PËR TË NGJITHA NIVELET, VITI 2024

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 38 pika 1 gërmat "ç"; *Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër*, neni 19, pika 2/b dhe 3/f, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.01.2024

**VENDOSI;**

1. Të miratojë strukturën akademike dhe administrative të UGJ-së për vitin 2024, sipas shtojcës nr. 1(një) bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë numrin e personelit të UGJ-së për të gjitha nivelet për vitin 2024, sipas aneksit 2 (dy) bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për të miratuar numrin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet, si dhe Administratorit,Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative dhe Drejtorisë së Shërbimeve Universitare.

***Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë!***

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

*Lidhja 1*

## STRUKTURA AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE E UGJ 2024

| Nr. | Emërtimi i strukturës | REKTORATI | FESHSH | FSHN | FE | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Rektor | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| 2 | Zv/Rektor | 2 (dy) | - | - | - | 2 (dy) |
| 3. | Dekan | - | 1 (një) | 1 (një) | 1 (një) | 3 (tre) |
| 4. | Zv/Dekan | - | 1 (një) | 1 (një) | 1 (një) | 3 (tre) |
| 5. | Departamente | - | 6 (gjashtë) | 3 (tre) | 3 (tre) | 12 (dymbëdhjetë) |
| 6. | Grupe mësimore-kërkimore | - | 2 (dy) | 4 (katër) | - | 6 (gjashtë) |
| 7. | Drejtori e Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| | Sektorë<br>a. Sektori i shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll;<br>b. Sektori i standarteve të cilësisë dhe korrikulave;<br>c. Sektori i shërbimeve bibliotekare-arkivore dhe studentore;<br>d. Sektori i kërkimit shkencor dhe | 4 (katër) | | | | 4 (katër) |

*Lidhja 1*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | marrëdhënjeve me jashtë. | | | | | |
| 8. | Administrator | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| 9. | Drejtoria e Shërbimeve Universitare | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| | Sektorë<br>a. Sektori i financë-prokurimeve;<br>b. Sektori i shërbimeve | 2 (dy) | - | - | - | 2 (dy) |
| 10. | Qëndra universitare ndërdisiplinore e kërkimit dhe zhvillimit | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| 11. | Biblioteka qëndrore | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| 12. | Sekretaria mësimore | 1 (një) | - | - | - | 1 (një) |
| 13. | Struktura Asistent i Dekanit | - | 1 (një) | 1 (një) | 1 (një) | 3 (tre) |
| 14 | Laboratore | - | 1(një) | 3(një) | 1(një) | 5 (pesë) |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

*Lidhja 2*

## NUMURI I PERSONELIT TË UGJ NË TË GJITHA NIVELET 2024

| Nr. | | REKTORATI | FESHSH | FSHN | FE | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Personel akademik | - | 58 (pesëdhjetë e tetë) | 32 (tridhjetë e dy) | 24 (njëzetë e katër) | ***114 (njëqind e katërmbëdhjetë)*** |
| 2 | Personel ndihmësakademik me karakter akademik | - | 1 (një) | 5 (pesë) | 1 (një) | ***7 (shtatë)*** |
| 3. | Personel ndihmësakademik me karakter administrativ | 23 (njëzetë e tre) | 2 (dy) | 2 (dy) | 2 (dy) | ***29 (njëzetë e nënëtë)*** |
| 4. | Personel administrativ | 31 (tridhjetë e një) | - | - | - | ***31 (tridhjetë e një)*** |
| | **Gjithësej** | ***54 (pesëdhjetë e katër)*** | ***61 (gjashtëdhjetë e një)*** | ***39 (tridhjetë e nëntë)*** | ***27 (njëzetë e shtatë)*** | **181 (njëqind tetëdhjetë e një)** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 19 Prot. Gjirokastër, më 05/01/2024

# VENDIM

Nr. 05, datë 05.01.2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE "NJËSISË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 38, pikat 3 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në nenin 19 pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e tij të datës 05.01.2024, pasi u njoh me draftin e ardhur nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë për Marrveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, dhe "Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor", Gjirokastër,

**VENDOSI**

Të miratojë:

1. Marrveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Gjirokastër, për realizimin e praktikave mësimore infermierore.
2. Një kopje pas protokollimit, i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

Rruga "Studenti" Lagjia "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408 web: www..uogj.edu.al email: rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" ÇABEJ

SENATI AKADEMIK

Nr 188 Prot. Gjirokastër, më 06/02/2024

# VENDIM

**Nr. 06, datë 06.02.2023**

## PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2023 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2024 DHE REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE 2024

Në zbatim të nenit 38 pika 3 të Ligjit 80/ 2015 *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë "*; Statutit të universitetit neni 19 pika 1/c dhe 1/f. Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024,

**VENDOSI**

Të miratoj:

1. Raportin Vjetor Financiar për vitin 2023.
2. Detajimin e Buxhetit për Vitin 2024 dhe Parashikimin e Prokurimeve Publike 2024.
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408 ,web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 189 Prot Datë 06.02.2024

# VENDIM

**Nr. 07, datë 06. 02 2024**

**PËR**

**MARRVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024, pasi diskutoji mbi marrveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale,

**VENDOSI**

1. Të miratoj marrveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrveshja pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408 ,web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKSSTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 190 Prot. Gjirokastër, më 06 / 02 /2024

# VENDIM

**Nr. 08 , datë 06.02. 2024**

## MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË "BACHELOR", CIKLIT TË DYTË" TË STUDIMEVE, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2 VJEÇAR DHE PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO - PEDAGOGJIKE PËR VITIN AKADEMIK 2025 - 2026

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe pika 3, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 76 pika 1 , neni 83 pika 1/ b , neni 135 , nenit 19 pika 3 / j të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej ", referuar niveleve 5 - 6 - 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe propozimeve të Njësive Kryesore të universiteti "Eqrem Çabej " me nr. 05/1 prot datë 16.02.2024 të FESHSH, nr. 11/2 prot, datë 16.01.2024 të FSHN dhe nr. 06 prot,datë 17.01.2024 të FE; Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 06. 02. 2024,

## VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2025 – 2026, si mëposhtë:
    a. Nota mesatare e përgjithshme arithmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore në masën 50 %.

b. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga njësitë kryesore (fakultetet) për çdo program studimi të ciklit të parë në masën 50 % ( sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.)

2. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2025-2026 (sipas shtojcës 3) .
3. Te miratojë kriteret e pranimit për studentë në programet me karakter profesional 2 vjeçar për vitin akademik 2025-2026 (sipas shtojcës 2).
4. Të miratojnë kriteret e pranimit për studentët në programin e formimit të vazhduar në fushën psiko – pedagogjike për vitin akademik 2025-2026 (sipas shtojcës 4).
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe publikohen në faqen zyrtare të universitetit .

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 191 Prot                                                  Datë 06/02 2024

**VENDIM**

**Nr. 09, datë 06. 02 2024**

**PËR ZGJEDHJET E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NIVEL INSTITUCIONAL**

Bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenin 28 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024 diskutoi për zgjedhjet e Komisioneve të Përhershme në nivel institucional dhe

**VENDOSI**

1. Të miratojë hapjen e procesi për zgjedhjen e përfaqësuesve në komisionet e përhershme në nivel institucional.
2. Rektori i UGJ-së të nxjerr urdhërin për zhvillimin e procesit zgjedhor.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**U N I V E R S I T E T I " E Q R E M Ç A B E J " G J I R O K A S T Ë R**

**SENATI AKADEMIK**

Nr 192 Prot                                                                                    Datë 06/02 2024

**VENDIM**

**Nr. 10 , datë 06.02 2024**

**PËR ZGJEDHJET E KËSHILLIT TË ETIKËS TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Bazuar në nenin 36 pika 5 dhe nenit 44 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenin 17 dhe nenin 24 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.02.2024 diskutoi për zgjedhjet e Këshillit të Etikës dhe

**V E N D O S I**

1. Të miratojë numrin total të Këshillit të Etikës prej 7 (shtatë) anëtarësh, me përbërjen si më poshte:
   a. 4 (katër) anëtarë përfaqësues të personelit akademik sipas kësaj shpërndarje: dy përfaqësues për FESHSH, një përfaqësues i FSHN; një përfaqësues i FE;
   b. një përfaqësues për i personelit ndihmës-akademik administrativ;
   c. një përfaqësues i personelit akademik administrativ;
   d. një përfaqësues i studentëve.
2. Rektori i UGJ-së të nxjerr urdhërin për shpalljen e procesit zgjedhor për zgjedhjet e Këshillit të Etikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 239 Prot Datë 14/02 2024

# VENDIM

## Nr. 11, datë 14.02 2024

## PROTOKOLL I PËRGJITHSHËM VEPRIMI MES UNIVERSITETIT KOMBËTAR NË DISTANCE (UNED) DHE UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR (UGJ)

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14.02.2024, pasi diskutoji mbi protokollin e përgjithshëm të veprimit me Universitetin Kombëtar në Distance (UNED),

## VENDOSI

1. Të miratoj protokollin e përgjithshëm të veprimit midis Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër dhe Universitetit Kombëtar në Distance (UNED), e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrveshja pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 240 Prot. Gjirokastër, më 14/02/2024

# VENDIM

**Nr. 12, datë 14.02.2024**

**PËR TRANSFERIM PERSONELI AKADEMIK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 38 pika 1/ç; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 19 pika 3/f; propozimit të Fakultetit Ekonomik Nr. 11 Prot., datë 06.02.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.02.2024, pasi konstatoj se procedura për trasferim personeli akademik në linjën njësi bazë – njësi kryesore – senat akademik ishte në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet rregullatore të UGJ-së,

## VENDOSI

1. Personelit akademik me kohë të plotë dr.Roland Vasili, i atashuar pranë Njësisë Bazë të Administrimit Publik, Fakulteti Ekonomik, të trasferohet pranë Njësisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.
2. Vendimit i bashkëlidhen propozimi i Njësisë Bazë të Administrimit Publik dhe konfirmimi i saj nga Dekani i Fakultetit Ekonomik.
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit, Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës-Akademike Administrative, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare, Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Përgjegjësit të Njësisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës.

***Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.***

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## SENATI AKADEMIK

Nr 241 Prot. Gjirokastër, më 14 / 02 /2024

## VENDIM

**Nr. 13 , datë 14.02.2024**

**MIRATIMI I KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË "BACHELOR" , CIKLIT TË DYTË" TË STUDIMEVE, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2 VJEÇAR DHE PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO - PEDAGOGJIKE PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 69 pika 3 dhe në zbatim të Statutit të UGJ-së, neni 62 pika 4, referuar niveleve 5-6-7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, dhe nenit 81, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe në mbështetje të Vendimit nr. 2, datë 12.02.2024 për miratimin e kuotave të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Vendimit nr. 02, datë 13.02.2024 të Fakultetit Ekonomik dhe Vendimit nr. 02, date 14.02.2024, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës; si dhe shkresës përcjellëse të Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave nr. 242 prot, datë 14.02.2024 Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 14.02.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve për vitin akademik 2024 -2025, për programet e ciklit të parë, ciklit të dytë, programeve me karakter profesional 2 vjeçar dhe programit të formimit të vazhduar në fushën psiko pedagogjike sipas shtojcës bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 351 Prot. Gjirokastër, më .04 / 03 /2024

# VENDIM

**Nr. 14 , datë 04. 03. 2024**

## PËR RIORGANIZMININ E PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË NË FUSHËN E MËSUESISË

**Në zbatim të Ligjit 80/ 2015** *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë* **", neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 83,** *Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër*, neni 63 pika 8, **VKM-së Nr. 185 datë, 25.03.2021,** për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe* **Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020** *për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë "* **Kreu IV/B** *"Dokumentacioni dhe procedura për riorganizimin e programeve të studimit mbi masën 20% të shprehur në kredite"* , Vendimit të Grupit Qëndror të ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit , nr. 2, datë 30.03.2023 "Për miratimin e lëndëve dhe krediteve për përafrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë nga grupet e punës sipas profileve, në kuadër të urdhërit të minitrit për "Përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë", *shkresës së MAS nr. 1366 prot datë, 19.02.2024 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve"*, **Vendimit të Njësisë Kryesore FESHSH,** Nr. 3, datë 28.02.2024, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 04. 03. 2024;

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë riorganizimin mbi masën 20% të shprehura në kredite, programet e studimit në ciklin e parë në fushën e mësuesisë Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" dhe "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" **me 180 ECTS,** i cili do të shtrihet në 3 (tre) vite akademike në sistemin me kohë të plotë .
2. Të miratojë riorganizimin mbi masën 20% të shprehura në kredite, programet e studimit në ciklin e dytë në fushën e mësuesisë **Master i Shkencave në "Mësuesi në Biologji Kimi", "Mësuesi në Gjuhë Angleze", "Mësuesi në Gjuhe Shqipe dhe Letërsi", "Mësuesi në Histori - Gjeografi", "Mësuesi në Matematikë Fizikë" dhe "Mësuesi në Matematikë TIK"** , me 120 ECTS, të cilat do të shtrihen në 2 (dy) vite akademike në sistemin me kohë të plotë .
3. Rregulloret e studimeve për programet e studimit në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të cilat riorganizohen.
4. Të miratojë dokumentacionin e fazës së dytë të aplikimit për riorganizimin e programeve të studimit në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR**

**SENATI AKADEMIK**

Nr 352 Prot Datë 04/03 2024

# VENDIM

**Nr. 15, datë 04.03 2024**

## PËR PROTOKOLLIN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR, SHQIPËRI DHE UNIVERSITETIT ERCIYES, TURQI

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 04.03.2024, pasi diskutoi mbi protokollin e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Shqipëri dhe Universitetit Erciyes, Turqi,

**VENDOSI**

1. Të miratoj protokollin e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Shqipëri dhe Universitetit Erciyes, Turqi, i cili i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Protokolli i bashkëpunimit pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

**SENATI AKADEMIK**

Nr 426 Prot. Gjirokastër, më 15/03/2024

# VENDIM

**Nr. 16 , datë 15.03.2024**

**MIRATIMI I RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR**

**Në zbatim të Ligjit 80/ 2015** *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë "*, **neni 35 pika 1, neni 38 pika dh, neni 83,** *Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër*, neni 63 pika 8, **VKM-së Nr. 185 datë, 25.03.2021,** për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe* **Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020** *për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë "* **Kreu IV/B** *"Dokumentacioni dhe procedura për riorganizimin e programeve të studimit mbi masën 20% të shprehur në kredite"* , Vendimit të Grupit Qëndror të ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit , nr. 2, datë 30.03.2023 "Për miratimin e lëndëve dhe krediteve për përafrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë nga grupet e punës sipas profileve, në kuadër të urdhërit të minitrit për "Përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë"*, shkresës së MAS nr. 1366/2 prot datë, 20.02.2024 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve"*, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës 15. 03. 2024;

**V E N D O S I**

1. Të miratojë rregulloren e studimeve për programin e studimit në ciklin e dytë Master Profesional në mësuesi për Arsimin Fillor 120 ECTS, i shtrirë në 2 vite akademike .
2. Të miratojë dokumentacionin e fazës së dytë të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit në ciklin e dytë Master Profesional në mësuesi për Arsimin Fillor (*120 ECTS*) .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408, web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 427 Prot. Gjirokastër, më 15 / 03 /2024

# VENDIM

**Nr. 17 , datë 15 . 03 . 2024**

**PËR**
**MIRATIM TË PERSONELIT AKADEMIK ME ANGAZHIM ME KOHË TË PJESSHME**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë "*, neni 38 pika 3; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej, neni 52, Senati Akademik, bazuar në kërkesën e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe të Marrëdhënieve me Jashtë Nr. 363 Prot., datë 06.03.2024, me objekt: "Kërkesë për atashimin e Sara Gace, pjesë e programit Fullbright, si personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme pranë Njësisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.03.2024

**VENDOSI**

1. Të miratojë atashimin e Sara Gace, si personel akademik me angazhim me kohë të pjesshme pranë FESHSH, në Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjieografisë.
2. Vendimi i përcillet Dekanit të FESHSH, Njësisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjieografisë, si dhe DSHNA-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr. Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**
**SENATI AKADEMIK**

Nr 443 Prot    Datë 19/03 2024

**VENDIM**

**Nr. 18 , datë 19.03 2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E KOMISIONIT TË HARTIMIT TË RREGULLORES SË ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"**

Duke u mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 131 dhe urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 101, datë 13.03.2024 pika 3 (tre); Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024 diskutoi për ngritjen e komisionit të hartimit të rregullores së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Cabej" dhe

**VENDOSI**

1. Komisioni për hartimin e rregullores së zgjedhjeve të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:
   a. juristi i institucionit;
   b. 3 (tre) përfaqësues të personelit akademik, nga një për secilën njësi kryesore;
   c. 1 (një) përfaqësues i trupës studentore.
2. Përfaqësuesit e personelit akademik nuk duhet të jenë autoritete të zgjedhura, si dhe kandidatë për autoritete dhe organe drejtuese në zgjedhjet e institucionit, **21 qershor 2024.**

Adresa: Lagjia "18 Shtatori",Rruga "Studenti", Gjirokaster , Tel: 842-6146, 63408 , Fax: 842- 637776, web: uogj.edu.al, email: rektori@uogj.edu.al

3. Përfaqësuesi studentor duhet të jetë studentë me kohë të plotë dhe të mos jetë kandidatë për anëtar të Senatit Akademik në zgjedhjet e institucionit, **21 qershor 2024.**
4. Sipas propozimeve në Senatin Akademik u shpallën fitues dhe u miratuan për anëtarë të komisionit të hartimit të rregullores së zgjedhjeve kandidaturat, si më poshtë:
    a. znj. Borana Lelaj, juriste e institucionit, me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm;
    b. z. Aleksandër Boboli (përfaqësues i FESHSH), me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm;
    c. z. Lutfi Gaba (përfaqësues i FE), me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm;
    d. znj. Arjeta Xhemali (përfaqësuese e FSHN), me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm;
    e. studenten Elona Tara (përfaqësuese e studentëve), me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

**SENATI AKADEMIK**

Nr 444 Prot. Gjirokastër, më 19 /03 /2024

**VENDIM**

**Nr. 19 , datë 19.03.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 3, DATË 15.01.2024 "STUDENTËT E PËRZGJEDHUR SI PËRFITUES, NGA LISTA E APLIKIMEVE QË I PLOTËSOJNË KUSHTET, NË PROGRAMET E STUDIMIT QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024"**

Në mbështetje të pikës 6, të VKM-së nr. 386, datë 01.06.2022 "*Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë*", të ndryshuar; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 230/9; shkesës së Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Granteve, nr. 233/9, si dhe duke iu referuar shkresës së administratorit të universitetit nr. 437, datë 19.03.2024, sipas së cilës studentja Greta Hamata e pragramit bachelor në Histori-Gjeografi, viti i parë, refuzoi nënshkrimin e marrëveshjes për përfitimin e mbështetjes financiare, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dorëheqjen e studentes Greta Hamata, pragrami bachelor në Histori-Gjeografi, viti i parë.
2. Rovena Dervishi, e pragramit bachelor në Histori-Gjeografi, viti i parë, përzgjidhet si përfituese, sipas të dhënave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim, si dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në formë shkresore dhe në rrugë elektronike.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!*

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408, web: www .uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al

*Shtojcë*

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**
**LISTA E STUDENTËVE PËRFITUES TË MBËSHTETJES FINANCIARE, PËRZGJEDHUR NGA LISTA E APLIKIMEVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET, SIPAS NOTËS MESATAR NË PRANIM, BAZUAR NË KËRKESAT E VKM NR. 386/2022, TË NDRYSHUAR**
**VITI AKADEMIK 2023-2024**

| Nr. | Emër, Atësi, Mbiemër | Nr. Indetifikimit të studentit | Fakulteti ku është regjistruar studenti | Program i studimit prioritar ku është regjistruar studenti | Nota mesatare në pranim e studentit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Rovena Maliq Dervishi | K55812022B | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore | Histori - Gjeografi | 7.78 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 461 Prot. Gjirokastër, më 21 /03 /2024

# VENDIM

**Nr. 20 , datë 21 .03 . 2024**

**MIRATIMI I MBYLLJES SË DY PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE CIKLIT TË DYTË**

Në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 35 pika 7, udhëzimit nr 1, datë 14.01.2020 , për " Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programet e studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë",Kreu IV pika C, udhëzimit nr 23, datë 28.09.2020, për një shtesë në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 , për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programet e studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", si dhe vendimeve të njësisw kryesore të FESHSH me nr. 4, datw 18.03.2024 dhe vendimit nr. 5 datw 18.03.2024, për arsye se për më shumë se 2 vite të njëpasnjëshme nuk ka pasur studentë të regjistruar, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 21. 03. 2024 ;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë mbylljen e programeve të studimit sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Të mos parashikojë kuota pranimi për vitin akademik 2024-2025;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

(shtojca 1)

## FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

| Nr | Programi i studimit | Ciklit i studimit | Kohezgjatja qe nuk ka studente te regjistruar |
|---|---|---|---|
| 1 | Histori dhe Gjuhë Italiane | Cikli i parë | 3 vite |
| 2 | Master ne AMU në Gjuhë dhe Qyteterim Italian | Cikli i dytë | 3 vite |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 462 Prot Datë 21/03 2024

# VENDIM

**Nr. 21, datë 21.03 2024**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**

**PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 57 pika 7; ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 dhe neni 131 pika 2; ligjit nr .9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar me ligjin nr. 9475, dt.9.2.2006, ligjin nr. 9529, dt.11.5.2006, ligjin 86/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014; ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.03.2024, pasi u njoh me draft-rregulloren hartuar nga grupi i punës, protokolluar me nr.455, datë 21.03.2024,

**VENDOSI**

1. Të miratojë me të gjitha votat e senatorëve të pranishëm rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër", e përbërë nga

39 nene gjithsej, të pasqyruara në 29 (njëzet e nëntë) faqe, si dhe të një aneksi, i pasqyruar në 1 (një) faqe.

2. Rregullorja i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Një kopje e vendimit së bashku me rregulloren, në zbatim të urdhërit të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 101, datë 13.03.2024, i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 605 Prot. Gjirokastër, më 15/04/2024

VENDIM
Nr. 22, datë 15.04.2024
PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË DOKTORATËS NË EDUKIM DHE SHKENCAT HUMANE NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E MAQEDONISË PERËNDIMORE (GREQI)**

**Në zbatim të Ligjit 80/ 2015** *"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë "*, **neni 3, neni 38 e në vijim,** Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 7, neni 19 e në vijim, **Vendimit nr. 41, datë 18.12.2018**, të Këshillit të Ministrave *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar* dhe **Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020** për "*Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë* " **Kreu IV/E** "Kriteret e posacme për hapjen e programeve të reja të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë", shkresës së MAS nr. 2313 prot., datë 04.04.2024 *"Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit"* , Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi draft – rregulloren për organizimin e programit e studimit të përbashkët në ciklit e tretë, në mbledhjen e tij të datës 15. 04. 2024;

VENDOSI

1. Të miratojë Rregulloren për organizimin e programit të përbashkët në ciklin e tretë në bashkëpunim me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore "Doktoratë" në Edukim dhe Shkencat Humane, (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, strukturat akademike dhe administrative të UGJ-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKSTËR**

**SENATI AKADEMIK**
